



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Politikën e Jashtme***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 09.07.2018, ora 11:30

**Drejton mbledhjen:**

**Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i kalendarit trejavor të punës së komisionit.
2. Projektligji “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Eficienca energjetike përmes sektorit bankar”, ratifikuar me ligjin nr. 89/2015”
3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së ndryshimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me marrëveshje me qeverinë e vendit pritës.”
4. Projektligji “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë””, ratifikuar me ligjin nr. 86/2015.
5. Çështje të tjera.

**Marrin pjesë:**

Mimi Kodheli, Eglandina Gjermani, Andrea Marto, Klotilda Bushka, Adnor Shameti, Ervin Bushati, Xhemal Qefalia, Edmond Panariti, Evis Kushi, Ilir Xhakolli

**Mungojnë:**

Tritan Shehu, Nard Ndoka, Elona Hoxha, Rudina Hajdari, Klevis Balliu, Vasilika Hysi,  
Klajda Gjoshaj, Edi Paloka dhe Edmond Panariti

**Të ftuar:**

Ilir Bejtja - Këshilltar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Enea Karakaçi - Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Stavri Dhima - Përgjegjës sektori në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Enkelelda Bako - Përgjegjëse sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Majlinda Hafizi - Drejtore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Anduena Hoxha - Përgjegjëse sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

## HAPET MBLEDHJA

**Mimi Kodheli** – Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë sot mbledhjen e Komisionit të Politikës së Jashtme.

Në rendin e ditës kemi diskutimin për miratim të projektligjit “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Eficienca energjetike përmes sektorit bankar”, ratifikuar me ligjin nr. 89/2015”.

Diskutimi i dytë është për projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së ndryshimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me marrëveshje me qeverinë e vendit pritës.”

Çështja e tretë është projektligji “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë””, ratifikuar me ligjin nr. 86/2015.

Të ftuar për pikën e parë dhe të dytë janë: zoti Ilir Bejtja, këshilltar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë; zoti Karakaçi, drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë; zoti Dhima, përgjegjës sektori në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë; znj. Enkeleda Bako, përgjegjëse sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë; znj. Hafizi, drejtore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe zonja Hoxha, Përgjegjëse sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

**Mimi Kodheli** – Zoti Karakaçi, fjala për ju.

**Enea Karakaçi** – Përshëndetje të gjithëve!

Në vitin 2015, nga ana e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, është miratuar ligji nr. 89/2015, që ishte, le të themi, miratimi i një marrëveshjeje financiare ndërmjet KfW dhe Republikës së Shqipërisë, për eficiencën e energjisë. Ky projekt, në atë kohë, konsistonte në krijimin e likuiditeteve për bankat e nivelit të dytë, në mënyrë që të mundësoheshin kreditë e buta për konsumatorët që kishin nevojë dhe kishin dëshirë të financonin investime në sektorin e eficiencës së energjisë. Pra, ky ishte projekti i vitit 2015.

Gjatë këtyre 2 vjetëve është konstatuar...

**Mimi Kodheli** – Një pyetje, të lutem!

Ju kërkoj ndjesë që ju ndërpreva!

Kur ju thoni: “Sektori i eficiencës së energjisë”, pra, financim me kredi të buta nëse dikush do të zhvillojë, për shembull, energjinë diellore?

**Enea Karakaçi** – Po. Pra, në kuptimin që dua të bëj një termoizolim.

**Mimi Kodheli** –Pra, termoizolim për t’u konsumuar më pas.

**Enea Karakaçi** - Po, në këtë kuptim.

Ideja është e tillë: gjatë këtyre viteve, në fakt, është konstatuar që kjo marrëveshje nuk është implementuar dhe shkak (këtë e kemi edhe nga komunikimet zyrtare që kemi pasur me KfW-në, por edhe me ambasadën gjermane) ishte që bankat nuk është se kishin mungesë likuiditetesh, por problemi ishte i garancive, që ato që kërkonin të merrnin kredi, do të merrnin po atë kredi që dëshironin dhe, si e tillë, deri në këtë vit, kjo marrëveshje ka ngelur e paimplementuar.

Në bashkëpunimin që kemi pasur me Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Bujqësisë, Ministrinë e Financave, me KfW-në dhe me ambasadën gjermane, është vlerësuar të vijohet me denoncimin e kësaj marrëveshjeje, pra, le të themi, me shfuqizimin e saj dhe kalimin e një granti 5 milionë euro në favor të Ministrisë së Bujqësisë.

Marrëveshja do të vijë sapo të denoncohet kjo marrëveshje, si dhe marrëveshja tjetër, që do ta prezantojë kolegja e Ministrisë së Financave, për një grant në fushën e bujqësisë, ku fondi që do të shërbejë për dhënien e këtij granti do të japë garancitë e nevojshme për bankat, pikërisht për marrjen e këtyre kredive të buta në fushën e bujqësisë. Prandaj është vlerësuar si oportune nga të gjithë aktorët, pra nga Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë, ministria jonë, bashkë me KfW-në

**Mimi Kodheli** – Pra, KfW-ja ka dështuar në këtë projekt. Paratë që mbeten i kalojnë një tjetër ministrie? Meqenëse në projektin që suporton Ministrinë e Bujqësisë vetë projekti hyn garant kur merr me kredi të buta apo grantet...

**Ilir Bejtja** – Është krijuar fondi i garancisë.

**Enea Karakaçi** – Kanë krijuar një fond të veçantë për garancinë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ilir Bejtja** – Kështu që 12-milionëshi mund të përdoret atje.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Mimi Kodheli** – Pse ky fond nuk u krijua si fond garancish për prodhimin e energjisë alternative? Ka të bëjë më një projekt tjetër?

**Ilir Bejtja** – Është tjetër formë. Janë disa kompani, që tregu ynë nuk i ka, ESCO quhen, të cilat bëjnë garantimin për institucionet, të cilat nuk mund të garantojnë.

**Mimi Kodheli** – Pse në rastin e Ministrisë së Bujqësisë kjo është e mundur të kryhet.

**Ilir Bejtja** – Është i krijuar fondi.

**Klotilda Bushka** – Çfarë fondi është ai?

**Enea Karakaçi** – Fondi rural për garancinë.

**Mimi Kodheli** - Kush e krijon fondin?

**Ilir Bejtja** – Është fondi i garancisë së kredive rurale.

**Enea Karakaçi** - Fondin e ka krijuar qeveria. Është i krijuar.

**Mimi Kodheli** – Këtë të bujqësisë?

**Ilir Bejtja** – Po.

**Mimi Kodheli** – Pse qeveria nuk krijon fond në fushën e energjisë?

**Ilir Bejtja** – Në fakt, ka disa arsye, por njëra prej tyre, në ligjin për eficiencën e energjisë, është krijimi i një fondi të eficiencës së energjisë, por çështja është e tillë...

**Enea Karakaçi** – Nuk është fond garancie.

**Ilir Bejtja** – Po pra, nuk është fond garancie, në kuptimin që akoma nuk janë gjetur masat, se cilat mund të jenë ato.

**Enea Karakaçi** – Tregu ynë e ka mekanizmin.

**Mimi Kodheli** – Në qoftë se qeveria, duke pasur mekanizma, ka krijuar një fond garancie në fushën e bujqësisë, po kjo qeveri, me po këto ligje, e ka mundësinë dhe i ka mekanizmat për të krijuar një fond garancie në fushën e energjisë, në mënyrë që ky fond të ndihmojë vetveten si projekt dhe jo të kalojë si garanci në një projekt komplet tjetër, sepse ju ia hiqni energjisë dhe vini këtu dhe thoni: “Me shumë dashuri po ia japim bujqësisë”, në një kohë, në vend që të luftoni, në gjykimin tim modest, si ekonomiste e vjetër që jam (se flas si ekonomiste këtu dhe jo si kryetare e Komisionit për Politikën e Jashtme, që duhet të merrem vetëm me “a është marrëveshja në përputhje me”), vini dhe thoni: ‘O, sa mirë që ky fond po na ikën nga duart, sepse për faj të qeverisë nuk është krijuar ky fondi, që mund ta përdorte atë si fond garancie për bankat e nivelit të dytë, për të vazhduar me aplikimin e pabëre deri më sot.’”

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ilir Bejtja** – Nuk është se nuk kemi pasur mbështetje me garanci sovrane. Që në fillim, kjo ka qenë ideja e bankës gjermane, që të ndihmojë bankat e nivelit të dytë të mbështesin projektet e eficiencës.

**Mimi Kodheli** – Bukur.

**Ilir Bejtja** – Nuk ka qenë fakti që nuk kanë pasur para.

**Mimi Kodheli** – Po flasim për garancinë, Ilir.

**Ilir Bejtja** – Po, pra. Kanë qenë vetëm kolaterale

**Mimi Kodheli** – Flasim për garanci kolaterale. Garancinë kolaterale, shteti, qeveria, e ka krijuar.

**Ilir Bejtja** - Nuk e kemi një program të tillë.

**Mimi Kodheli** - Këtë po them, që qeveria...

**Enea Karakaçi** – A mund të shprehem?

**Mimi Kodheli** – Nuk ke çfarë më shpjegon. Unë po pyes pse. Nuk duhet të shpjegojmë mekanizmin.

**Enea Karakaçi** – Ideja është e tillë. Një projekt ka nevojë edhe të implementohet, për të parë mangësitë. Kur është bërë miratimi në vitin 2015, ajo çfarë vlerësohej si e mjaftueshme nga KfW-ja dhe nga palët e tjera përkatëse, nga ministria jonë, Ministria e Financave, Ministria e Jashtme, ishte dhënia e likuiditeteve për bankat.

Këta dy vjet implementim, sigurisht, shërbyen për të vlerësuar se çfarë duhej bërë më mirë. Nuk është se ne ishim dakord, pra edhe ne nuk kishim dëshirë, por erdhëm në këtë pikë të detyruar, në njëfarë mënyre, sepse këto fonde digjen në fund të viti 2018 dhe po të mos alokoheshin në këtë mënyrë, që të përfitonte, le të themi, qeveria shqiptare, mund të digjeshin. Prandaj u arrit të behej ky lloj kompromisi.

**Mimi Kodheli** – Dakord.

Kam edhe një koment. Pastaj zonja Bushka ka një pyetje për të bërë.

Ky është dështim i përbashkët, i qeverisë dhe i KfW-së, i qeverisë shqiptare dhe i mekanizmit që ka përdorur qeveria...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Është një hap mbrapa i dështimit që ka pasur qeveria shqiptare me qeverinë gjermane, që ka dhënë paratë, lidhur me mosfunksionimin e këtij fondi garancie, në mënyrë që bankat të mund të lëvronin para, thoni ju.

**Ilir Bejtja** – Tani është konceptuar në këtë formë. U zbulua që tregu shqiptar nuk ka mjaftueshëm garanci kolaterale ose financiare për të mbështetur iniciativa të tilla.

**Mimi Kodheli** – Kjo ndodh për shkak të studimeve të munguara të fizibilitetit, përpara se KfW-ja t'i jepte këto para...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ilir Bejtja** – Projektet në bujqësi mund të gjejnë shumë më lehtë mbështetje sesa projekte të tilla me eficiencë të energjisë.

Edhe sot që flasim, ka kompani që dalin garante, quhen Energy Service Company (ESCO), që u dalin garant atyre që nuk mund të ofrojnë mbështetje kolaterale, por janë më të vogla se vetë projektet.

**Mimi Kodheli** – Profesor, njerëzit në botën perëndimore *care* për të përdorur energji alternative, për aq kohë sa energjia mungon. Kaq.

Ju thonë se meqë paratë po digjen dhe po vjen fundi i vitit, o burra, t'i hedhim te një projekt tjetër, meqë ne nuk jemi të zotë t'i thithim. Sistemi energjetiko-bankar i Shqipërisë nuk është në gjendje t'i thithë këto. Kaq. Paratë janë ato që janë.

**Ilir Bejtja** – Ka para edhe për ne në treg. Domethënë, gabimi ka qenë që në perceptim. Perceptimi i tyre ka qenë: “Të ndihmojmë sistemin bankar me mjete likuide. Në fakt, nuk ka rezultuar ky problemi. Ne edhe sot e kësaj dite mund të marrim kredi në treg, por prapë jemi në të njëjtat situata.

**Mimi Kodheli** – Profesor, dëgjo Mimin një sekondë.

E kuptoj. KfW-ja ka bërë atë punë që ka bërë. Ti e ke bërë me ligj këtë gjë dhe ditën që ke bërë ligj, unë, që kam qenë në qeverinë e 2015-s, unë (jo ti), qeveria shqiptare, nuk kam kuptuar që ky ligj ishte i destinuar të mos funksiononte, sepse ka pasur një mungesë apo një abstenancë studimi fizibiliteti të sistemin bankar, që është më shumë se evident, që ka një ligj, që po nuk vure një barrë ose po nuk garantove në likuid *available* në çdo moment atë kredimarrësin, ti kredinë nuk e merr. Nuk ka më a, b, c... Ti ke bërë ligjin. E ke sjellë ligjin në parlament dhe e ke miratuar. Ky është një dështim, le ta themi, dhe këto para që të mos humbasin, se gjynah...

**Ilir Bejtja** – Në momentin kur kemi firmosur marrëveshjen, nuk kemi qenë kundër në kuadrin e të gjithë mbështetjes së qeverisë gjermane, që tregut tonë t'i hynë dhe 12 milionë euro.

**Mimi Kodheli** – Absolutisht.

**Ilir Bejtja** – Ata kanë zgjedhur si partner Procredit-in. Procredit-i ka fonde të vetat, që nuk i shet dot, pikërisht për arsyen që po themi, jo më të vazhdojë të shesë fondet e KfW-së dhe kjo është arsyeja që po i vëmë një *shift*.

**Mimi Kodheli** – Po, po. KfW-ja e ka pasur gabim.

**Ilir Bejtja** – Në rastin konkret, ne e kemi fondin që zgjidh anën kolaterale dhe, e dyta, bankat e nivelit të dytë nuk financojnë kredi bujqësore. Atje kemi treg. Është më e lehtë. Të paktën këtë e vendos KfW-ja ta destinojë atje.

**Mimi Kodheli** – Ke të drejtë, profesor. Nuk dua të bëj debat tani, se presupozohet që ne duhet t'i miratonim dhe të ngrinim vetëm dorën këtu. Ke të drejtë, por pse duhet të zgjedhim rrugën...?

**Ilir Bejtja** – Gjithë hallin e kam se nuk është faji i qeverisë.

**Mimi Kodheli** – E di.

Por pse duhet të zgjedhim rrugën më të lehtë? Unë e kuptoj prioritetin që i japim bujqësisë, por ndërkohë duhet t'i japim edhe sektorit të energjisë një prioritet tjetër. Dakord? Ne zgjedhim rrugën më të lehtë. Te kjo më e lehta, zgjedhim gjithmonë më të lehtë dhe ngelim gjithmonë të lehtë. Mund të bënim edhe ndonjë gjë më të rëndë. Ky ishte komenti im.

**Ilir Bejtja** – Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Me sa kuptoj unë, projektligji që na sillni ka të bëjë me faktin e fillimit të procedurës, që të zgjidhni marrëveshjen që kishit në 2015-n, e cila nuk funksionon më.

**Ilir Bejtja** – Po, t'i hapë rrugë marrëveshjes së re.

**Klotilda Bushka** – Domethënë, ajo gjë ka mbaruar, nuk do të ekzekutojë dot më, prandaj quhet denoncim. Nga negociatat është gjetur mundësia që ky fond të kalojë për bujqësinë.

**Mimi Kodheli** – Nuk dihet se sa do të funksionojë, por kjo është histori tjetër.

**Klotilda Bushka** – Ideja është që këto para të mos i humbim dhe është gjetur kjo rrugë.

Kur keni bërë marrëveshjen e 2015-s, eficiencën e energjisë, në kuadrin e rifinancimit të projekteve, e keni pasur për zonën rurale dhe zonën urbane, kështu e lexoj në titull. Tani po e kaloni te zona rurale për efekt se gjetët mjetin kush do ta garantojë.

Një gjë nuk kuptoj, te ruralja, cilat do të jenë projektet ku do të fokusohet financimi, sepse flasim për eficiencën e energjisë, ashtu siç e kuptoj me aq njohuri sa kam. Bëhet fjalë për...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Energjinë e mbyllëm.



**Mimi Kodheli** – Do të vijë marrëveshja e re dhe do të jetë edhe një përfaqësues i Ministrisë së Bujqësisë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Enea Karapaçi** – Këta sapo thanë që nuk jepet kredi për bujqësinë.

**Ilir Bejtja** - Bankat i japin, se janë paratë e KfW-së dhe e vendos ajo.

**Mimi Kodheli** – Kush është dakord?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Fjala për zonjën Enkeleda Bako

**Enkeleda Bako** – Faleminderit!

Ky projektligj që kemi sjellë është një bashkëpropozim i Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, pra është ratifikimi i marrëveshjes së ndryshimit mes Republikës së Shqipërisë duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe *Trans-Atlantic Pipeline AG* lidhur me marrëveshjen me qeverisë e vendit pritës. Në fakt, ndryshimi i propozuar ka si qëllim që të përfshijë në marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës, e cila është ratifikuar me ligjin nr. 116 të vitit 2013, dispozitat që rregullojnë trajtimin e tatimit mbi vlerën e shtuar për aktivitetet e ndërtimit gjatë fazës së ndërtimit të projektit TAP.

Aktualisht gazsjellësi TAP operon dhe zbatohet ligji “Për tarimin mbi vlerën e shtuar”, ashtu sikurse edhe për sistemin e furnizimeve të tjera të mallrave dhe shërbimeve për të cilat aplikohet tarimi mbi vlerën e shtuar në vendin tonë, pra, si një furnizim normal. Normalisht investitori kryesor paguan tatimin mbi vlerën e shtuar në import apo gjatë blerjes së mallrave e shërbimeve dhe i rimbursohet. Në marrëveshjen me gazsjellësin TAP është planifikuar që periudha e rimbursimit, ndryshe nga subjektet e tjera që operojnë në vendin tonë, të jetë për një afat prej 180 ditësh për shkak të vlerave të konsiderueshme për t’u rimbursuar.

**Mimi Kodheli** – Sa është borxhi që keni sot?

**Enkeleda Bako** – Nga të dhënat më të fundit që unë kam mund të them se me TAP-in është lidhur një marrëveshje skandencimi për ta rimbursuar muaj për muaj në një vlerë rreth 300 milionë lekë. Në fakt, vlera e konsiderueshme e rimbursimit çoi në...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Mimi Kodheli** – Besoj se ky projektligj nuk ka fuqi prapavepruese.

**Enkeleda Bako** – Absolutisht jo.

**Mimi Kodheli** - Sa është borxhi?

**Enkeleda Bako** – Diku te 2 miliardë.

**Mimi Kodheli** – Si do ta paguani këtë?

**Enkeleda Bako** – Normalisht është planifikuar të paguhet çdo muaj nga 300 milionë lekë.

**Mimi Kodheli** – Ndërkohë për borxhin TVSH që krijohet nga ky moment e tutje si do veprohet?

**Enkeleda Bako** – Presupozohet që nuk do të krijohet borxh TVSH-je për investitorin, tashmë do të funksionojë me një skemë tjetër, që kombinon sistemin e autofaturimit, ose siç njihet nga gjuha e TVSH-së *reversecharging*, me sistemin normal të TVSH-së. Pra, investitori i projektit, kontaktorët e nivelit të parë, të cilët do t'i zgjedhë vetë investitori, si dhe kontraktorët e nivelit të dytë, nuk janë ata që e paguajnë TVSH-në, normalisht dhe parimisht është furnizuesi i mallit ose shërbimit ai që e paguan. Në këtë rast investitori i projektit dhe kontraktorët e nivelit të parë do të sjellin sikur bëjnë furnizime për veten e tyre, duke autofaturuar, pra TVSH-ja do të netohet, domethënë TVSH-ja që ishte për t'u paguar me TVSH-në me të drejtë zbritjeje, TVSH-në për t'u rimbursuar.

**Mimi Kodheli** - ....qeverinë që të mos nxjerrë para.

**Enkeleda Bako** – Në një farë mënyrë lehtëson pjesën e qeverisë, pra ato burime të administratës që do të përdoren për të kontrolluar kërkesat e herëpashershme të investitorit për rimbursim, sepse bëhen kërkesa shumë të shpeshta dhe në vlera të larta rimbursimi.

**Mimi Kodheli** – Ku është hilja këtu?

**Enkeleda Bako** - Është një skemë realisht lehtësuese dhe që aplikohet tashmë, madje e aplikon edhe kompania Devoll *Hydropower*, Statkraft me ligjin nr. 105 të vitit 2013 dhe është e njëjta skemë si e Devollit. Normalisht kjo bëhet për të shfrytëzuar ato burime monetare për të rimbursuar eksportuesit dhe të tjerë.

**Mimi Kodheli** – Ju nuk jeni punonjëse e Ministrisë së Financave?

**Enkeleda Bako** – E Ministrisë së Financave jam.

**Klotilda Bushka** – Unë e shoh marrëveshjen dhe i kam tekstet këtu. Çfarë nënkuptoni me “furnizues të parë” dhe “furnizues ndërkombëtar”? 80 nga ata do të jenë të përjashtuar nga furnizimi.

**Enkeleda Bako** – Përfitojnë nga skema, jo se janë të përjashtuar, sepse TVSH-ja është tatim konsumi, ajo paguhet dhe rimbursohet. Kurse këtu, që në momentin e parë që do të kryhet

furnizimi, TVSH-ja do të netohet direkt, TVSH-ja për t'u paguar me TVSH-në e zbritshme dhe më pas të rimbursueshme.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Mimi Kodheli** – Zoti Bushati, a keni ndonjë koment tjetër?

**Ervin Bushati** – Si po shkon puna me rimbursimin e firmave shqiptare?

**Enkeleda Bako** - Me eksportuesit, apo në përgjithësi?

**Ervin Bushati** – Në përgjithësi.

**Enkeleda Bako** – Nga informacioni që kam, sepse këto shqetësime janë paraqitur si në Ministrinë e Financave, ashtu dhe në Ministrinë e Ekonomisë dhe ne i kemi trajtuar me strukturën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, më specifikisht me Drejtorinë e Rimbursimit të TVSH-së, e cila është një drejtori e posaçme, që trajton rimbursimin e TVSH-së, eksportuesit paraqesin kërkesa të vazhdueshme për rimbursim, pothuajse muaj për muaj. Të paktën nga ana e Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së janë ankuar kur ka pasur raste të ndonjë vonese në dhënien e rimbursimit për shkak të volumit shumë të madh të kërkesave për rimbursim.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Në një shtet të rregullt do të paguanin edhe kamatëvonesë.

E hedhim në votë.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Ju falënderoj për prezencën!

Ditën e mirë!

**Mimi Kodheli** – Kalojmë te pika e tretë, që është projektligji “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë”, ratifikuar me ligjin nr.86/2015.

Për këtë projektligj kemi ftuar zonjën Anduena Hoxha, përgjegjëse sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Po, zonja Hoxha.

**Anduena Hoxha** – Faleminderit!

Më lejoni të sqaroj dy momente. Është në kuadrin e të njëjtit ligj, të të njëjtit protokoll dhe është bashkëpunim mes dy palëve, qeverisë gjermane dhe asaj shqiptare u dakordësua dhe u sanksionua me ligj që në datën 6 korrik 2015 zbatimi i këtyre dy projekteve, domethënë efienca e energjisë nëpërmjet sistemit bankar dhe rifinancimi i SME-ve në zonat urbane e rurale. Dy *gaps*-e, ose dy handikapët ishin se nuk u bë më përpara një *feasibility study* dhe se në termat e referencës së projektit nuk u parashikua fondi i garancisë për të minimizuar riskun e moskthimit të marrjes së kredisë. Këto ishin dy momentet që sollën si pasojë bërjen e denoncimit ose të anulimit të ligjit të marrëveshjes.

Pyetja ishte pse nuk e rimarrim që ta bëjmë aktive për SME-të, flas për projektin tonë. Arsyeja është sepse është miratuar dhe ka goxha likuiditete projekti me BERZH-in për 100 milionë për SME-të, kështu që ky 5 milionëshi nuk ka ndonjë peshë si kredi e butë me 2 apo 3 %. Kështu që e mori bujqësia dhe e negocioi me KfW-në për ta kaluar atje.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, nuk e kthejmë, thjesht ndryshuan destinacionin dhe termat e referencës së projektit.

**Mimi Kodheli** – A ka pyetje?

**Klotilda Bushka** - Po vlera e këtij fondi sa është?

**Anduena Hoxha** – 5 milionë.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Adnor Shameti** – Pra 17 milionë në total.

**Mimi Kodheli** - E hedhim në votë.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Ju falënderoj për prezencën!

Ditën e mirë!

**MBYLLET MBLEDHJA**